

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

RREGULLORE E PUNËS E ASEMBLESË SË KOK-ut

Miratuar nga Asambleja e KOK,

Prishtinë, 21.12.2016

Në bazë të nenit 5.2.xiii të Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës, Asambleja e KOK, në mbledhjen e vet të mbajtur në Prishtinë më 21.12.2016 aprovoi këtë:

PROJEKT RREGULLORE TË PUNËS SË ASEMBLESË SË KOK-ut

Kapitulli I: Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

- 1.1 Me këtë Rregullore dhe në përputhje me dispozitat e Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës, përcaktohet mënyra e organizimit dhe e punës së Asamblesë së Komitetit Olimpik të Kosovës (më tutje KOK): mbledhja e Asamblesë, organizimi dhe mbarëvajtja e seancave të Asamblesë, përgatitja e rendit të ditës, marrja e vendimeve të Asamblesë, zgjedhja e Presidentit të KOK, Nën-Presidentëve, Bordit ekzekutiv, Këshillin e Arbitrazhës Sportive, Komisionit Mbikqyrës të KOK, marrja e vendimeve të nevojshme në Asamble, mbajtja dhe përpilimi i procesverbalit, njoftimi i anëtarëve të KOK-ut me vendimet e Asamblesë.
- 1.2 Mbledhjet e Asamblesë së KOK-ut janë:
- 1.2.1 Mbledhjet e Asamblese se përgjithshme
 - 1.2.2 Mbledhjet e Asamblesë së jashtezakonshme
 - 1.2.3 Mbledhjet e Asamblese se përgjithshme Zgjedhore
 - 1.2.4 Mbledhjet e Asamblese se KOK-ut shenohen me numra romak duke filluar nga mbledhja zgjedhore dhe me radhë deri te mbledhja tjetër e Asamblesë.

Neni 2

- 2.1 Dispozitat e kësaj Rregulloreje aplikohen ndaj delegatëve të Asamblesë dhe pjesëmarrësve tjerë në Asamble.
- 2.2 Dispozitat sipas 2.1. nuk aplikohen ndaj mysafirëve të ftuar në pjesën solemne.

Kapitulli II: Seancat e Konventës

Neni 3

- 3.1 Asambleja e Përgjithshme Zgjedhore e KOK (në tekstin e mëtejme Asambleja) mbahet në Prishtinë, më 21 Dhjetor 2016.
- 3.2 Asambleja ka dy seanca: Seanca Solemne dhe Seanca e Punës.
- 3.3 Mbledhjet e Asamblesë sipas natyrës janë publike, me prezencë të mysafirëve, mediave dhe të ftuarve tjerë.
- 3.4 Seanc Solemne është publike.
- 3.5 Në Seancën e Punës marrin pjesë mediat dhe të ftuarit tjerë, por jo mysafirët dhe pjesëmarrësit tjerë.

3.6 Me propozim të ndonje anëtari të Asamblesë së KOK, të BE të KOK apo të Presidentit, Asambleja mund të sjellë vendim të largohen mjetet e informimit ose Asambleja të deklarohet e mbyllur për publikun.

Neni 4

Presidenti i KOK, respektivisht Kryesuesi i Asamblesë përkujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Seanca Solemne

Neni 5

5.1 Pjesa solemne fillon me intonimin e Himnit Shtetëror dhe Himnit të KON.

5.2 Konventën e shpall të hapur Presidenti i KOK.

5.3 Pas fjalës së Presidentit, Asamblesë mund t'i drejtohen edhe mysafirët për të përshëndetur.

Seanca e Punës

Neni 6

6.1 Mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë së KOK-ut e përgatitë Bordi Ekzekutiv i KOK-ut

6.2 Bordi Ekzekutiv i KOK-ut miraton vendimin dhe aktin për të cilat anëtarët e Asamblesë do të deklarohen në Asamblesë të përgjithshme.

6.3 Bordi Ekzekutiv i KOK-ut përcakton Rendin e ditës për mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme.

Neni 7

Miratimi i Rendit të Ditës

7.1 Në bazë të raportit të Komisionit Verifikues shpallet ekzistimi i kuorumit për filimin e punimeve të Asamblesë.

7.2 Asambleja mund të debatojë dhe të marrë vendime nëse në punimet e saj marrin pjesë më shumë se gjysma e delegatëve me të drejtë vote.

7.3 Ndryshimet dhe plotesimet e rendit të ditës pas mbledhjes së Bordit Ekzekutiv në të cilën është miratuar propozimi i rendit të ditës për mbledhje janë të mundshme brenda afatit të caktuar me Statutin e KOK-ut.

7.4 Nëse propozimi është dorëzuar me shkrim me arsyetim dhe me tekst të bashkangjitur për vendimin që duhet të merret.

7.5 Nëse propozimi i dorëzohet Sekretarit të përgjithshëm 21 ditë para fillimit të mbledhjes së Asamblesë.

- 7.6 Nëse propozimin e ka bërë anëtar i Asamblesë.
- 7.7 Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës që nuk i plotëson këto kushte nuk do të shqyrtohet në mbledhjen e caktuar nëse Asambleja nuk vendos ndryshe.
- 7.8 Presidenti i njofton anëtarët e Asamblesë me propozimet e vlefshme për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës
- 7.9 Asambleja miraton rendin e ditës me shumicën e votave të pjesëmarrësve ashtu që së pari deklarohet për rendin e ditës të propozuar nga Bordi Ekzekutiv e pastaj për propozimin për ndryshime dhe plotësime të rendit të ditës
- 7.10 Pas perfundimit të deklarimit, Presidenti lajmëron për miratimin e rendit të ditës dhe procedon me punë sipas pikave të rendit të ditës.

Neni 8

- 8.1. Për pika të Rendit të Ditës diskutimet mund të zgjasin deri në 5 minuta.
- 8.2. Pas raportimit për pikë të caktuar, Presidenti hap diskutimin dhe fton diskutuesit sipas radhës së paraqitjes për diskutim.
- 8.3. Askush nuk mund të marrë fjalën pa lejen paraprake të Presidentit.
- 8.4. Diskutuesi mund të flasë vetëm për pikën konkrete për të cilën debatohet.
- 8.5. Çdo diskutues mund të propozojë zgjidhje konkrete për çështjen për të cilën debatohet, nëse diskutimi nuk është i natyrës informuese.
- 8.6. Për piken e Rendit të ditës diskutuesit mund të merr fjalën vetëm një herë.
- 8.7. Replika lejohet nëse diskutimi paraprak ka pasur të bëjë me replikuesin.
- 8.8. Replika mund të zgjatë deri 2 minuta.
- 8.9. Derisa debatohet diskutuesi mund të tërheqë propozimin e tij.

Neni 9

Mbarvajtja në mbledhje.

- 9.1 Askush nuk ka të drejtë ta ndërpresë diskutuesin, t'i ndërhyjë ose me veprime sugjестive të ndikojë në rrjedhën e lirë të mendimit të tij.
- 9.2 Nuk lejohet të ofendohet ose të provokohet ndonjë diskutues.
- 9.3 Në rast se prishet rregulli në mbledhje, Presidenti shqipton masën e vërejtjes.
- 9.4 Në rast kur rregulli në mbledhje dëmtohet rënd ose përseritet, Presidenti përsëritë masën e tërheqjes së vërejtjes apo mund të largoi personin i cili edhe pas tërheqjes së vërejtjeve vazhdon me dëmtimin e punës së mbledhjes.
- 9.5 Nëse folësi e demton rendin në mbledhje, Presidenti ia tërheq vërejtjen dhe pas vërejtjes së dytë ia merr fjalën.
- 9.6 Nëse në mbledhje vjen deri të dëmtimi i Kodit të Etikës së KON-it, Presidenti është i obliguar të nis procedurën përkatëse në pajtim me Statutin e KOK-ut dhe rregullat e KON-it.

Neni 10

- 10.1 Debati sipas rregullit vazhdon deri në përfundimin e listës së diskutuesve të lajmëruar për diskutim.
- 10.2 Asambleja vendos, sipas propozimit të Presidentit, ta ndërpresë debatin nëse mendon se pika është shtjelluar në atë masë sa mund të merren vendime meritore.
- 10.3 Pas përmbylljes së diskutimit për një çështje të caktuar, Asambleja merr vendim në bazë të dispozitave të Statutit të KOK-ut dhe të kësaj Rregulloreje.
- 10.4 Së pari votohet sipas renditjes së propozimeve e pastaj për çështjen në tërësi.
- 10.5 Të gjitha propozimet miratohen me shumicë (50+1 përqind) të votave të delegatëve të pranishëm në Asamble, përveq çështjeve që rregullohen ndryshe me statut dhe me këtë rregullore.

Kapitulli III: Verifikimi i Mandateve, Kandidimi dhe Votimi

Neni 11

- 11.1 Me arritjen në vendin ku mbahet mbledhja, anëtarët e Asamblesë janë të obliguar të paraqiten të shërbimi profesional i KOK-ut për ta marrur akreditimin për mbledhje dhe për tu evidentuar prezenca në mbledhje si dhe për marrjen e listave për paraqitje për diskutime sipas pikave të Rendit të ditës.
- 11.2 Shërbimi profesional jep akreditimet në bazë të raportit të Sekretarit të përgjithshëm duke respektuar Statutin e KOK-ut:
- 11.3 Sekretari i përgjithshëm përpilon raportin zyrtar se kush janë delegatë me të drejtë vote dhe kush pa të drejtë vote.
- 11.4 Në bazë të dokumenteve të arritura, Sekretari i përgjithshëm para cdo mbledhje të Asamblesë përpilon raportin e azhuruar i cili i dergohet zyrtarit për akreditim ose komisionit verifikues

Neni 12

Rrjedha e mbledhjes

- 12.1. Mbledhjen e hap dhe e udhëheqë Presidenti i KOK-ut respektivisht personi i cili me Statutin e KOK e zëvendson.
- 12.2. Në udhëheqjen e mbledhjes së Asamblesë së KOK-ut, Presidentin e ndihmon kryesia e punës, përbërjen e të cilës e përcakton: Presidenti i KOK-ut tre anëtar dhe Asambleja dy anëtar.
- 12.3 Në udhëheqjen e mbledhjes merr pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm.
- 12.4 Presidenti njofton për kuorumin dhe për fillimin e seancës së punës.

12.5 Para fillimit të shqyrtimit të Rendit të ditës, Asambleja zgjedh një procesmbajtës dhe një verifikues të procesverbalit.

Neni 13.

Komisioni Verifikues

13.1 Para fillimit të shqyrtimit të Rendit të ditës, zgjedhet Komisioni Verifikues i cili në bazë të raportit të Sekretarit të përgjithshëm dhe numrit të akreditimeve të lëshuara përpilon raportin për Asamblesë lidhur me verifikimin e mandateve dhe për prezencën e tyre në mbledhje.

13.2 Komisioni verifikues mund të formohet edhe si trup i përhershëm punues i Asamblesë me c'rast ka kryetarin, zëvendësin dhe 4 anëtar.

13.3 Komisioni verifikues ka të drejtë dhe obligim ta shikoj tërë dokumentacionin në bazë të të cilit është përpiluar raporti i sekretarit të Përgjithshëm.

13.4 Në bazë të raportit të Komisionit verifikues, Presidenti deklaron a ekzistojnë kushtet për të vazhduar me seancën e punës.

Neni 14

Lajmërimi për diskutime

14.1 Anëtarët e Asamblesë të cilët duan ti drejtohen Asamblesë lidhur me ndonjë pikë të rendit të ditës janë të obliguar që të dorëzojnë te Sekretari i përgjithshëm listën për lajmërim për diskutim para hapjes së mbledhjes e për shkaqe të arsyeshme më së voni deri në miratimin e Rendit të ditës.

14.2 Përsoneat që me vonesë e dorëzojnë listën për lajmërim, ose nuk e dorëzojnë, nuk kanë të drejtë ti drejtohen Asamblesë përveç në rastin kur Kryesia e punës për shkaqe të arsyeshme vendos ndryshe.

Neni 15

Kuorumi

15.1 Nëse mungojnë shumica e anëtarëve të Asamblesë, Presidenti e ndërpreu ose e shtyen mbledhjen duke përcaktuar menjëherë kohën e mbajtjes, nëse është e mundshme.

15.2 Për vazhdimin e mbledhjes së ndërprerë ose të shtyer nuk dorëzohen serish ftesat dhe materialet.

15.3 Anëtarët e Asamblesë të cilët nuk kanë qenë prezent në mbledhjen e cila është ndërprerë ose shtyer informohen me email ose faks për datën e vazhdimin të mbledhjes.

Neni 16

Shqyrtimi

16.1 Për çdo pikë të rendit të ditës mund të bëhen diskutime nëse për atë pikë ka të lajmëruar për diskutime.

16.2 Presidenti ua jep fjalën të lajmëruarve për diskutime.

16.3 Anëtarët e Asamblesë diskutojnë sipas rënditjes së pranimit të listave lajmëruese.

16.4 Anëtarët e kryesisë së punës të Asamblesë dhe Sekretari i përgjithshëm me lejen e Presidentit mund ti drejtohen çdoherë Asamblese lidhur me çështjet që shqyrtohen sipas Rendit të ditës.

16.5 Presidenti mund ti drejtohet Asamblesë çdoherë lidhur me çështjet që shqyrtohen sipas Rendit të ditës.

Neni 17

Vendimet

17.1 Asambleja merr vendime dhe konkluzë me vota të hapura, nëse Asambleja nuk vendos ndryshe.

17.2 Votimi i hapur bëhet me ngrije të dorës, ose me kartona me ngjyre të përgatitur për votim "PER", "KUNDER", "ABSTENIM".

17.3 Nëse në Rendin e ditës të mbledhjes së rregullt ka zgjedhje, emërim ose largime, në pikat e tilla aplikohen rregullat e votimit të percaktuara për mbledhjen e Asamblese zgjedhore.

17.4 Nëse Asambleja vendos të votohet fshehtas, votimi bëhet me lista të votimit dhe këtë e udhëheqë Komisioni i pavarur zgjedhor i përbër nga tre anëtarë të zgjedhur nga Asambleja.

17.5 Komisioni i pavarur zgjedhor me ndihmën e shërbimit profesional të KOK-ut kryen numërimin e votave dhe e informon Presidentin.

17.6 Propozimi është miratuar nëse për të janë deklaruar shumica e anëtarëve të Asamblesë që janë prezent përveç kur votohet për çështje që me Statut është percaktuar ndryshe.

17.7 Kur vendoset për çështje që kanë të bëjnë me Lojerat Olimpikë, në harmoni me Statutin për të drejtën e votimit për keto çështje, Presidenti percakton dhe e lajmron kuorumin për sjellje të vendimeve të tilla.

17.8 Presidenti kumton rezultatin e votimit dhe konstaton a është miratuar vendimi i propozuar.

17.9 Vendimet që nuk miratohen e që kanë qenë në Rendin e ditës, sipas vendimit të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut mund të propozohen sërish në rendin e ditës në ndonjërin nga mbledhjet e radhës së Asamblesë.

Neni 18

Mbyllja e mbledhjes

Me përfundimin e të gjitha pikave të rendit të ditës, Presidenti njofton për përfundimin e punimeve të Asamblesë së KOK-ut.

Neni 19

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë

19.1 Për thirrjen e Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblesë zbatohen rregulla të njëjta sikurse edhe për mbledhjet e Asambleve të rregullta nëse bëhet nga personi i autorizuar me Statut të KOK-ut.

19.2 Mbledhja e jashtëzakonshme e ftuar me kërkesën e Presidentit ose Bordit Ekzekutiv (50%+1) ose të anëtarëve të Asamblesë (50%+1) duhet të caktohet dhe të mbahet më së voni në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës. Nëse Presidenti nuk e thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të Asamblesë në afatin e caktuar, për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Asamblesë aplikohen kushtet në vijim:

19.2.1 Nënpresidenti i parë është i obliguar ta caktoj mbledhjen e jashtëzakonshme në afatin prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së rrethanave të tilla. Nëse edhe nënpresidenti i parë nga cilado arsye nuk e thërret mbledhjen e Asamblesë, të drejtën për caktimin e mbledhjes së Asamblesë e merr nënpresidenti i dytë me obligimin që në afatin prej 15 ditësh nga paraqitja e rrethanave që e autorizojnë, ta caktoj mbledhjen.

19.2.2 Nëse nuk mund të sigurohet caktimi i mbledhjes së jashtëzakonshme në meyrë të tillë, të drejtën e Presidentit e merre anëtari më i vjetër i Bordit Ekzekutiv i cili është i obliguar të ftoj mbledhjen e Asamblesë.

Neni 20

Mbledhja e Asamblese se pergjithshme zgjedhore

20.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore konvokohet duke u respektuar procedurat e njëjta të thirrjes së mbledhjes së rregullt të Asamblesë të parapara e statutin e KOK-ut.

20.2 Mbledhja e Asamblesë Zgjedhore në të cilën zgjedhen organet dhe trupat e KOK-ut mbahet më së voni gjashtë muaj nga dita e përfundimit të Lojërave Olimpikë Verore.

20.3 Anëtarët e Bordit Ekzekutiv të cilëve u mbaron mandati mbesin në funksione të tyre deri në përfundimin e procesit zgjedhor.

20.4 Presidenti i KOK-ut udhëhqe mbledhjen zgjedhore të Asamblesë së KOK-ut deri në zgjedhjen e Presidentit të ri i cili atëherë e merr udhëheqjen e mbledhjes.

Neni 21

Zgjedhja e Komisionit të Pavarur Zgjedhor

Bazuar në Statutin e KOK-ut, në Asamblenë e përgjithshme para asaj Zgjedhore zgjedhet Komisioni i Pavarur Zgjedhur (KPZ)

Neni 22

Zgjedhja e Presidentit të KOK-ut

22.1 Kandidati/ kandidatët të cilët kanë konkuruar për tu zgjedhur president i KOK-ut duhet ti plotësojnë kritetet e parapara e statutin e KOK-ut.

22.2 Kandidatët para procedurës së votimit duhet të paraqesin programin për udhëheqjen e KOK-ut për ciklin olimpik para delegatëve të Asamblesë.

22.3 Nëse për postin e Presidentit paraqitet dhe mbetet vetëm një kandidat, zgjedhja bëhet me aklamacion.

22.4 Nëse për postin e Presidentit paraqiten dhe mbeten vetëm dy kandidatë, zgjedhja bëhet me votim të fshehtë dhe ai/ajo që fitojnë 50%+1 të votave konsiderohet i/e zgjedhur.

22.5 Nëse për postin e Presidentit paraqiten më shumë se dy kandidatë, i zgjedhur konsiderohet ai/ajo që kanë 50%+1 të votave, nëse asnjeri kandidatë nuk ka arritur të fitojë 50%+1 të votave, organizohet raundi i dytë i votimit ku mbesin dy kandidatët që kanë fituar vota me së shumti.

Neni 23

Zgjedhja e Nënpresidentëve të KOK-ut

23.1 Te gjitha federatat, anëtare të KOK-ut me të drejtë vote, kanë të drejtë të propozojnë kandidatin e tyre për Nënpresident duke respektuar afatet e percaktuara më statut.

23.2 Nëse janë propozuar katër kandidatë për postin e Nënpresident, një votim i fshehtë do të organizohet për tu bërë renditja nga Nënpresidenti i parë deri të Nënpresidenti i katërt.

23.3 Nëse ka me shumë se katër propozie për postin e Nënpresidentit të KOKut, ata që fitojnë më shumë vota se 50%+1 konsiderohen të zgjedhur.

23.4 Votimet do të përsëriten deri sa të zgjedhen 4 Nënpresidentët duke fituar nga 50%+1 të votave.

Neni 24

Zgjedhja e nje sportisti anetar BE të KOK-ut

24.1 Komisioni i sportistëve të KOK-ut, duke respektuar afatin e caktuar do të caktojë dy përfaqësues të tij për Asamblenë Zgjedhore të KOK-ut (mundësisht një mashkull dhe një femër).

24.2 Këta përfaqësues duhet të jenë pjesëmarrës të së paku njëres nga tri edicionet e fundit të Lojërave Olimpike Verore.

24.3 Njëri nga këta dy sportistë duhet të zgjedhet anëtar i BE të KOK-ut nëpërmjet votimit të fshehtë.

24.4 Nëse vetëm njëri nga sportistët kandidohet për postin e anëtarit të BE të KOK-ut zgjedhja bëhet me aklamacion.

Neni 25

Zgjedhja e anëtarëve të BE të KOK-ut

25.1 Bordi Ekzekutiv i KOK-ut përbëhet nga 15 anëtarë. Presidenti, 4 Nënpresident, 1 sportist dhe 9 anëtarë të BE të KOK-ut.

25.2 Në këtë përberje duhet të dominojnë përfaqësuesit e federatave Olimpike dhe duhet të ketë së paku 4 femra.

25.3 nga 9 anëtarët e BE të KOK-ut Presidenti i posazgjedhur mund të shfrytëzojë të drejtën të propozojë 3 anëtar të BE të KOK-ut, të cilët do të votohen nga Asambleja.

25.4 Federatat Olimpikë që kanë tre përfaqësues në Asamblesë të KOK-ut, mund të propozojnë dy kandidatë për poste në BE të KOK-ut (preferohet njëri të jetë i gjinisë femërore).

25.5 Federatat tjera që kanë më pak se tre përfaqësues mund të kandidojnë vetëm për një pozitë.

25.6 Nëse për anëtare të BE të KOK-ut do të kandidohen delegatë sa është numri i anëtarëve që do të zgjedhen, zgjedhja bëhet me aklamacion.

25.7 Në fletëvotime shënohen emrat dhe mbiemrat e kandidatëve dhe sporti të cilin e përfaqësojnë, sipas numrit rendor, duke e respektuar rendin alfabetik.

25.8 Kryetari i KPZ fton një nga një përfaqësuesit e Federatave me të drejtë vote të cilët e marrin fletën e votimit, shkojnë në kabinën e votimit, votojnë duke rrethuar numrin para kandidatëve, e palosin fletëvotimin dhe e vendosin në kutinë e votimit e cila duhet të jetë transparente.

25.9 Me përfundimin e votimit, KPZ zbrazë kutinë e votimit dhe fillojnë me numrin e votave duke konstatuar së pari vlefshmerinë e fletë votimit, pastaj duke i numëruar votat publikisht.

25.10 Fletëvotime të pavlefshme konsiderohen:

- a. fletëvotimet ku shihet se nuk është shënuar numri i asnjërit nga kandidatët;
- b. fletëvotimet ku janë rrethuar me shumë numra se sa numri i atyre që do të zgjedhen;
- c. fletëvotimet ku nuk shihet qartë se për cilin kandidatë është votuar.

25.11 Anëtar i Asamblesë i cili nuk është zgjedhur nga Asambleja për anëtar të BE të KOK-ut mbetet anëtar i Asamblesë.

Neni 26

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe të Këshillit të Arbitrazhës sportive të KOK-ut

26.1 Federatat sportive, anëtare me të drejtë vote në KOK, kanë të drejtë të kandidojnë përfaqësuesit e tyre për Këshillin Mbikqyrës (5 anëtarë) dhe për Komisionin e Arbitrazhës sportive (9 anëtarë).

26.2 Nëse paraqiten më pak kandidatë se sa janë paraparë të zgjedhen, KPZ shtyen afatin për dy ditë dhe i njofton Federatat se mundën të propozojnë kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret e kërkuara.

26.3 Nëse ka kandidatë të propozuar për Këshillin mbikqyrës dhe për Komisionin e Arbitrazhës sportive aq sa edhe do të zgjedhen, zgjedhja do të bëhet me aklamacion.

26.4 Nëse ka më tepër kandidatë, për cilindo Komision, votimi bëhet me vota të fshehta dhe zgjedhen ata që kanë fituar më së shumti vota.

Neni 27

Procesverbali

27.1 Gjatë punës së Asamblesë mbahet Procesverbali i cili duhet të përmbajë:

- a) Emërtimi "Procesverbal nga Asambleja";
- b) Numrin rendor të Asamblesë;
- c) Emërtimin e natyrës së punës së Asamblesë;
- d) Vendin dhe datën e mbajtjes;
- e) Orën e fillimit të punimeve;
- f) Emrin e Kryesuesit dhe të anëtarëve të Kryesisë së Punës;
- g) Numrin e delegatëve pjesëmarrës;
- h) Anetaret e Asamblese, emrin personal të pjesëmarrsit (ose konstatimin për raportin me shkrim të shërbimit profesional që mbetet pjesë përbërëse e Procesverbalit), emrin personal të Procesmbajtësit, konstatimin për prezencën e personave të tjerë;
- i) Rendin e propozuar dhe të miratuar të punës;
- j) Emrat e diskutuesve në seancën e diskutimit dhe veçanërisht propozimet e tyre;
- k) Vendimet dhe konkluzionet me numër të votave "për", "kundër" dhe "abstenim";
- l) Përcaktimin e orës së mbylljes së punimeve;
- m) Nënshkrimet e Presidentit ose Kryesuesit dhe të Procesmbajtësve dhe të Verifikuesve të Procesverbalit;
- n) Komisionet punuese, emrat e tyre;
- o) Propozimet;
- p) Procesverbali nga mbledhja duhet të përpilohet më së voni brenda 7 ditëve nga përfundimi i mbledhjes
- q) Procesverbali ju dorezohet anëtarëve të Asamblesë brenda 30 ditëve duke i ftuar që brenda 7 ditëve të paraqesin vërejtjet eventuale në procesverbal. Nëse anëtari i Asamblesë paraqet vërejtjet brenda afatit të caktuar, për të njëjtin deklarohen Presidenti dhe procesmbajtësi dhe e informojnë parashtruesin e vërejtjes;
- r) Anëtari i Asamblesë mundet sipas rregullave për propozimin e ndryshimit dhe plotesimit të rendit të ditës të kërkojë që vërejtjet në procesverbal të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së Asamblesë;
- s) Për nevojat zyrtare të KOK mund të përpilohen ekstraktet nga Procesverbali të cilat i verifikon Sekretari i Përgjithshëm;

27.2 Aktet e miratuara, raportet dhe analizat në kopje duhet t'i bashkangjiten procesverbalit.

27.3 Procesverbali ruhet si dokument me vlerë të përhershme.

Neni 28

Dispozita përfundimtare

28.1 Kjo Rregullore konsiderohet e miratuar nëse për të votojnë shumica e anëtarëve prezent.

28.2 Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëher në momentin e miratimit nga Asambleja.

28.3 Kjo rregullore mundë të ndryshohet me procedure të njëjt.

28.4 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen të gjitha Rregulloret e mëparshme të punës së Asamblesë.

Për BE të KOK-ut,

Besim Hasani, President i KOK-ut

Tel/Fax: +381 38 222 223; Mob: +377 44 622 000; info@noc-kosovo.org; www.noc-kosovo.org
Adresa: Rr. Agim Ramadani nr. 253, Shtëpia e Sporteve, kati I, nr. 10, 10000 Prishtinë, Kosovë